



UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"

REKTORI

Nr. 2565 prot.

Shkodër, më 07.07.2016

U D H Ë Z I M

Për regjistrimin e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të USh-së.

Bazuar në ligjin nr. 80 /2015, "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 38, pika gj, neni 48, pika 1,2 dhe vendimin nr.312, datë 06. 07. 2016, të Senatit Akademik,

udhëzoj:

1. Hapjen e fushatës së regjistrimit të kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit të USh-së.
2. Kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit mund të vetëkandidohen apo propozohen nga njësitë bazë të USh-së.
3. Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e miratuara në vendimin nr.312, datë 06. 07. 2016 të Senatit si mëposhtë:
 - a. Të jetë pedagog me kohë të plotë në USh.
 - b. Të ketë të paktën gradën shkencore "Doktor".
 - c. Të mos jetë i zgjedhur si autoritet apo në organet drejtuese të USh-së.
4. Nuk mund të kandidojnë për anëtar të Bordit të Administrimit anëtarët e personelit akademik që:
 - a. Janë në ndjekje penale dhe ndaj tyre është dhënë masë e sigurimit personal;
 - b. Janë dënuar për vepra penale me vendim gjyqësor të formës së prerë;
 - c. Janë të dënuar me parë për vepra penale;

d. Ndaj tyre është dhënë masë disiplinore.

5. Dokumentacioni për kandidim dorëzohet pranë sekretares së rektorit çdo ditë nga ora 8:00 - 13:00, deri më datë 20. 07. 2016. Dokumentat që duhet të dorëzohen:

a. Kërkesën për kandidim e shoqëruar me CV.

b. Deklarimin që nuk është i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë për vepra penale; deklarin se nuk ka shkak për të qënë objekt i ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrijnë funksione publike” dhe ligjit nr. 45/2015 “ Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-sigurimit të shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;

c. Kopje të dokumentit të identifikimit;

d. Fotokopje të titullit akademik.

6. Pas verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar, sekretari i Senatit Akademik harton listën e kandidatëve për anëtarë të Bordit të Administrimit dhe Komisioni i statutit , i rregulloreve dhe i disiplinës bën publike listën e kandidatëve plotësojnë kriteret e vendosura në vendimin 312, datë 06. 07. 2016 të Senatit Akademik duke e shpallur në faqen zyrtare të USh-së.

7. Mbi bazën e listës së miratuar të kandidatëve hartohen fletët e votimit për anëtarë të Bordit të Administrimit të USh-së.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.



REKTORI

Prof. dr. Adem BEKTESHI